



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 57/2019 regjistër (JR)
Datë 11.11.2019

Nr. 31 i vendimit
Datë 18.11.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 18.11.2020, ditën e mërkurë, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES:

1. Subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër.

2. Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI I ANKIMEVE:

Shqyrtimi i vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE:

1. Për ankimin e subjektit të rivlerësimit:

Neni 42 i Kushtetutës, nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 63-66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për ankimin e Komisionerit Publik:

Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 e F të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten e tij Romina Zano, të cilët përfundimisht, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e prokurorit dhe drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
- (ii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- (iii) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
- (iv) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj.*

1.3 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të

¹ Raport i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 08.01.2018.

² Raport i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017.

përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 187, datë 24.07.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 187, datë 24.07.2019, vendosi pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj, me detyrë prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 44, shkronja “b”, 58, pika 1, shkronja “b” dhe 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij, por ka pasur pamjaftueshmëri të mjeteve financiare në shumën 826.717 lekë, për pagesën e këstit të parë për pasurinë e ndodhur në Durrës. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Mungesa e të ardhurave për pagesën e këstit të parë nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se, në lidhje me vlerësimin e figurës, subjekti është i përshtatshëm për të vazhduar detyrën.

3.3 Për kriterin e vlerësimit profesional:

Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, si më poshtë vijon.

- Në tetë raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore.

- Në dy raste, Komisioni ka konstatuar njohuri të cekëta të subjektit të rivlerësimit në lidhje me figurën e veprës penale.

- Në tri raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët për analizimin e masës së dënimit të kërkuar.

- Në tri raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e provave të administruara.

³ Raport i përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2018.

- Në dy raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në analizimin e provave dhe argumentimin e masës së sigurimit konform neneve 229-230 të K.Pr.Penale.

- Në një rast, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta në lidhje me të drejtat e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

- Në 10 raste, Komisioni ka konstatuar një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë.

Pavarësisht pozicionit të tij si drejtues prokurorie dhe shpjegimeve të tij për përgjegjësi të prokurorit dhe jo drejtuesit, Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumenteve me kërkesat e prokurorëve përpara gjykatës si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

III. Shkaqet e ankimeve

5. Kundër vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit kanë ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj dhe Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”).
6. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik dhe i kundërankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, janë evidentuar, në mënyrë të përmbledhur, sa vijon.

A. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

7. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.10.2019⁴, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 187/1, datë 24.10.2019.
8. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e tij, nuk është pajtuar me vendimin nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, pasi konstatimet që referohen si mangësi në aftësitë profesionale janë vendime, një pjesë e të cilave janë marrë nga prokurorë të tjerë dhe, duke qenë se këto vendime nuk kanë sjellë pasoja në mbarëvajtjen e hetimeve dhe gjykimeve, atëherë bien poshtë pretendimet e Komisionit për mangësi në aftësitë profesionale. Subjekti ka paraqitur kundërshtimet e tij si më poshtë.

8.1.1 Përfundimet e Komisionit për dokumentin “Konkluzione përfundimtare”, të paraqitur në Gjykatën e Apelit Shkodër, për vendimin penal nr. {***}, datë 02.04.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, bien ndesh me parashikimin e nenit 72, paragrafi i katërt i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8.1.2 Konstatimet e Komisionit në lidhje me dokumentin “Konkluzione përfundimtare” për çështjen e themelit, pa rekurs, me nr. {***} vendimi dhe datë 15.02.2016, nuk qëndrojnë, pasi subjekti ka vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe ka mbështetur këtë vendim.

⁴ Ankimi i subjektit të rivlerësimit është protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 22.10.2019.

8.1.3 Për dokumentin “Konkluzionet përfundimtare”, për çështjen e themelit, me rekurs, me nr. {***} vendimi dhe datë 17.07.2014, konstatimet e Komisionit nuk janë të drejta, pasi raporti i Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka konstatuar mangësi profesionale.

8.1.4 Në lidhje me dokumentin “Vendimi i drejtuesit të prokurorisë datë 07.01.2013, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, datë 23.10.2012, dhe zëvendësimin e prokurores”, konstatimet e Komisionit qëndrojnë lidhur me shfuqizimin e vendimit të pushimit nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, por kjo nuk duhet konsideruar si mangësi profesionale, në kuptim të logjikës së hierarkisë institucionale në organet e drejtësisë.

8.1.5 Lidhur me procedimet penale nr. {***} dhe {***}, të vitit 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatimet e Komisionit nuk qëndrojnë, pasi është e vërtetë se hetimi është dëmtuar në momentin kur janë arrestuar në flagrancë shtetasit S. B. dhe A. B., por kjo nuk ka ndodhur si pasojë e ndërhyrjes së subjektit të rivlerësimit apo e prokurorit tjetër, por tregon dukshëm se ka qenë vlerësimi i policisë gjyqësore për të kapur në flagrancë personat e dyshuar që po kryenin aktin korruptiv.

8.1.6 Në lidhje me materialin kallëzues nr. {***} dhe procedimin penal nr. {***}, Komisioni nuk jep asnjë argument ligjor se përse veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë shkelje. Subjekti ka vepruar në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

8.1.7 Lidhur me fashikullin nr. {***} të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimmarrja është e një prokurori tjetër dhe jo vendim i subjektit të rivlerësimit, çka e çliron atë nga përgjegjësia si drejtues lidhur me vendimet e prokurorëve të tjerë.

8.1.8 Në lidhje me trajtimin e denoncimit të shtetas D.M., Komisioni mund të kishte shfrytëzuar hapësirat ligjore për ta thirrur denoncuesen për të dhënë shpjegime, siç ka vepruar në raste analoge. Nga ana e Komisionit, vendimet e prokurorëve në Prokurorinë e Elbasanit janë konstatuar si shkelje të subjektit të rivlerësimit. Vendimi i Komisionit është i paargumentuar, për faktin se është e pamundur që subjekti të justifikojë qëndrimet e prokurorëve të veçantë në çështje të veçanta, ku nuk ekziston asnjë provë, e dhënë apo indicie që subjekti të ketë qenë drejtpërdrejt i implikuar në vendimmarrjet e tyre. Për më tepër, këto vendime dhe kërkesa kanë kaluar filtrin e gjykatës, nga ku rezulton se kanë qenë të drejta, përderisa qëndrojnë në fuqi.

9. Në përfundim, në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

B. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

10. Komisioneri Publik, më datë 25.10.2019⁵, ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, ankim i pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 187/2, datë 25.10.2019.
11. Komisioneri Publik, në ankimin e tij, ka konstatuar se, për sa i takon vlerësimit të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, janë të gabuara dhe nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet e provat e administruara. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri Publik ka kundërshtuar vendimin nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, duke kërkuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

⁵ Ankimi i Komisionerit Publik Darjel Sina është protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 25.10.2019.

11.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke parashtruar se:

a) Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 76 m², në Durrës, në referencë të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për këtë pasuri.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar depozitat e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së tij me persona të tjerë të lidhur, depozita këto të krijuara në periudhën 2006-2010. Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara në këtë periudhë.

11.2 Për cenimin e besimit të publikut, Komisioneri Publik ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke parashtruar se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, kjo situatë vlerësohet se cenon besueshmërinë e tij në respektimin e ligjit e, për rrjedhojë, edhe besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për më tepër, në kushtet kur nga vlerësimi i aftësive profesionale, një numër i konsideruar i rasteve me mangësi të theksuara në gjykim janë konstatuar si rezultat i denoncimeve të ardhura nga publiku, si dhe kur Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, ka konkluduar përshtatshmërinë e subjektit në mungesë të informacionit nga ShISH, thellohet bindja për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

12. Në përfundim, Komisioneri Publik ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj.

C. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

13. Kundër ankimit ndaj vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, të paraqitur nga Komisioneri Publik më datë 29.10.2019⁶, ka paraqitur kundërankim subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj, i cili ka kërkuar që Kolegji të rrëzojë/mos pranojë ankimin e Komisionerit Publik, duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

13.1 Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji mospranimin e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, pasi:

a) në Kushtetutë është parashikuar shprehimisht se ndaj vendimit të Komisionit, me disponimin e pezullimit nga detyra për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, nuk lejohet ankim, prandaj ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet;

b) ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet edhe sepse është depozituar në tejkalim të afateve ligjore për depozitimin e tij.

13.2 Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas paragrafit 11.1.a si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se pretendimet e Komisionerit Publik nuk janë të mbështetura në asnjë provë konkrete, pasi gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ai ka paraqitur prova të mjaftueshme, si dhe një raport të hartuar nga një ekspert kontabël i miratuar, sipas të cilit rezulton se ka pasur mjaftueshëm aftësi financiare për pagimin e kështit të parë për blerjen e apartamentit në Durrës.

⁶ Kundërankimi i subjektit të rivlerësimit është protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 29.10.2019.

13.3 Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas paragrafit 11.1.b si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me depozitat dyemërore janë të pabazuara në provat e dorëzuara prej tij, të administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, pasi:

(i) pas takimit sqarues të datës 17.02.2016 të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, nëna e tij, znj. S. G., më datë 06.06.2016, ka kaluar çdo llogari në emër të saj, si titullare e vetme e llogarive bankare, pa lënë asnjë person të autorizuar apo të besuar për të kryer veprimet;

(ii) për të provuar të ardhurat e ligjshme të prindërve të tij, si dhe faktin se këto të ardhura nuk kanë qenë të tijat, subjekti ka paraqitur në Komision dokumentacion provues për burimin e të ardhurave të babait të tij. Lidhur me depozitën dyemërore midis bashkëshortes dhe nënës së saj, subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale si dokumentacion provues për të ardhurat nga emigracioni i djemve të znj. P., si dhe për të ardhurat nga pensioni i familjarëve të bashkëshortes;

(iii) referuar ligjit nr. 84/2016, subjekti ka provuar me prova se depozitat dyemërore nuk kanë qenë dhe nuk janë të ardhurat e tij apo të bashkëshortes së tij. Këto depozita nuk kanë qenë asnjëherë në pronësi, posedim apo përdorimin e tij ose të bashkëshortes së tij, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003;

(iv) të ardhurat ndër vite të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij kanë qenë të mjaftueshme për jetesën, depozitat, si dhe likuiditetet përkatëse.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi shqyrtimin së bashku të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe të ankimit të Komisionerit Publik, në të njëjtin proces. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe të ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 187, datë 24.07.2019, si dhe kundërankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndaj ankimit të Komisionerit Publik, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.
15. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor duke paraqitur disa prova të reja, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 45, 49, 50 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016, vendosi:
 - (i) çeljen e hetimit gjyqësor;
 - (ii) të pranojë marrjen në cilësinë e provës të disa prej akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe t'ua nënshtrojë ato debatit gjyqësor⁷. Aktet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit u vlerësuan nga trupi gjykues se, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, janë të panevojshme dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, edhe nëse konsiderohet i vërtetë fakti që kërkohet të provohet;
 - (iii) të marrë kryesisht në cilësinë e provës dy akte shkresore të cilat lidhen me vlerësimin e bërë nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 1-vjeçare të trajnimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe t'ua nënshtrojë ato debatit gjyqësor⁸;

⁷ Trupi gjykues mori në cilësinë e provës e-mail-e të printuara nga posta elektronike e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. Rr. G., të vërtetuara njësisht me origjinalin me akt noterial nr. {***} rep., datë 28.09.2020.

⁸ Trupi gjykues mori kryesisht në cilësinë e provës shkresën nr. {***} prot., datë 02.07.2020, të Shkollës së Magjistraturës, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shkresën me nr. {***} prot., datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

(iv) kryerjen nga Komisioneri Publik të një analize të plotë financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të.

16. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, në seancën gjyqësore të datës 06.11.2020, u debatua analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik⁹, e cila i ishte vënë në dispozicion nga trupi gjykues paraprakisht subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij¹⁰. Pas zhvillimit të debatit gjyqësor, trupi gjykues, në funksion të qartësimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik lidhur me depozitat dyemërore të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nënën e tij dhe nënën e saj, i kërkoi Komisionerit Publik të paraqiste analizën financiare për vlerësimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij për krijimin e tyre me burime financiare të ligjshme, deri në datën e çeljes së këtyre depozitave.
17. Në seancën gjyqësore të datës 11.11.2020, u debatua analiza financiare e përgatitur nga Komisioneri Publik¹¹, me të cilën subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij ishin vënë në dijeni paraprakisht nga trupi gjykues¹².

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

18. Në lidhje me ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se duhet të analizojë çështjen e legjitimitetit të subjektit të rivlerësimit në paraqitjen e ankimit për shqyrtim në Kolegj, në këndvështrimin *ratione materiae*, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe në nenin F, pika 2 e Aneksit të saj.
Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, bazuar në parashikimet kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit, si dhe bazuar në nenin 13 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, ankimi i tij duhet të pranohet.
Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili ka gjetur transpozim në nenet 58, pika 2 dhe 60 të ligjit nr. 84/2016, parashikon dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe, me këtë rast, detyrimin e tij për ndjekjen e një programi edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës. Dhënia e kësaj mase disiplinore nënkupton që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është kryer për të tria kriteret e vlerësimit dhe subjekti ka rezultuar me nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës, por në vlerësimin e aftësive profesionale janë evidentuar mangësi, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet ndjekjes prej tij të programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës. Parashikimi i nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës “2. *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit.*”, ndalon në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e së drejtës së ankimit nga subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke i dhënë disponimit të

⁹ Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.11.2020, ka përcjellë në Kolegj të gjitha shkaqet e ankimit, për të cilat vlerëson se mbeten për t'u marrë në shqyrtim e për t'u gjykuar nga ana e trupit gjykues të Kolegjit dhe analizën financiare për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m² në Durrës dhe për llogaritë dyemërore të bashkëshortes së tij me prindërit e subjektit të rivlerësimit dhe nënën e bashkëshortes.

¹⁰ Analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik iu vu në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe avokates Romina Zano, me shkresën nr. {***} regjistër (JR), datë 04.11.2020.

¹¹ Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2020, ka përcjellë në Kolegj analizën mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij për krijimin e depozitave dyemërore në datën e krijimit të tyre.

¹² Analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik iu vu në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe avokates Romina Zano, me shkresën nr. {***} regjistër (JR), datë 09.11.2020.

Komisionit për vlerësimin e këtij kriteri, statusin e një vendimi përfundimtar të formës së prerë.

Në mbështetje të parashikimeve të këtyre dispozitave kushtetuese, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet *ratione materiae* për të vënë në lëvizje Kolegjin me kërkimin e ndryshimit të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë, pasi, sipas nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ndaj vendimit që ka dhënë masën disiplinore të pezullimit nga detyra me detyrimin për të ndjekur programin 1-vjeçar të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, nuk mund të ushtrohet ankim.

19. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues konstaton se me shkresën nr. {***} prot., datë 20.07.2020¹³, Komisioni ka përcjellë në Kolegj rezultatet e provimit përfundimtar pranë Shkollës së Magjistraturës, për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj. Këto rezultate ishin përcjellë më parë në Kolegj edhe nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {***} prot., datë 02.07.2020¹⁴. Me anë të kësaj shkrese, Shkolla e Magjistraturës informon organet e rivlerësimit se: “Me vendimin nr. {***}, datë 03.20.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, është miratuar programi i trajnimit për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj, që konsiston në ndjekjen e lëndëve: E drejtë penale, Procedurë penale, Etikë profesionale, Shkrim dhe arsyetim ligjor, E drejtë kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, E drejtë e Bashkimit Evropian, si dhe ndjekjen e aktiviteteve trajnuese në programin e formimit vazhdues për temat e trajtuara në fushat e mësipërme të së drejtës. Në përfundim të programit të trajnimit, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar me mbi 70% të pikëve totale dhe sipas vlerësimit me shkallë, vlerësohet në nivelin *Mirë*”.

Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka kryer detyrimin për ndjekjen e programit të trajnimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas urdhërimit të dispozitivit të vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit. Në këto kushte, ankimi i ushtuar nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim të urdhërimit të këtij vendimi, nuk është më një ankim efektiv, lidhur me mundësinë e një rehabilitimi të mundshëm, si pasojë e pranimit eventual të ankimit.

20. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës vlerëson se ankimi i subjektit të rivlerësimit nuk pranohet.

C. Mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me legjitimitimin e Komisionerit Publik të parashtruar në kundërankim

21. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në kundërankim, ka kërkuar nga Kolegji mospranimin e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, duke parashtruar sa vijon.

a) Në Kushtetutë është parashikuar shprehimisht se ndaj vendimit të Komisionit me disponimin e pezullimit nga detyra për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, nuk lejohet ankim, prandaj ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet.

b) Ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet edhe sepse është depozituar në tejkallim të afateve ligjore për depozitim të tij.

Në pretendimin e tij se ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet, pasi në Kushtetutë është parashikuar shprehimisht se ndaj vendimeve të marra sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk lejohet ankim, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se nuk mund të bëhet interpretim që ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim për pjesë të veçanta të arsytimit të tij, pasi në të kundërt Kushtetuta dhe ligji do të kishin parashikuar se në këto

¹³ Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.07.2020.

¹⁴ Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.07.2020.

raste Komisioni mund të dilte me disponim të dyfishtë, konfirmimin për dy shtylla vlerësimi dhe pezullimin për shkak të mosplotësisë të shtyllës së tretë. Sipas subjektit të rivlerësimit, e drejta e ankimit i njihet vetëm atij si subjekt rivlerësimi, për një arsyetim më të favorshëm në vendim, por kursesi Komisionerit Publik.

22. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, si dhe në vijim të arsytimit të bërë në paragrafët 18-20 në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se nga leximi i parë literal i nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, duket sikur ndalimi i së drejtës kushtetuese të ankimit për Komisionerin Publik, për vendimet e marra nga Komisioni të cilat disponojnë pezullimin nga detyra për subjektin e rivlerësimit për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, është absolut, në kuptimin e shtrirjes së këtij ndalimi për çdo lloj shkak potencial ankimi nga Komisioneri Publik. Por, nga një lexim i kujdesshëm dhe një interpretim logjik, rezulton se parashikimi i nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm me ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit nga subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke i dhënë disponimit të Komisionit për vlerësimin e këtij kriteri, statusin e një vendimi përfundimtar të formës së prerë, ndërsa, për sa u përket dy kritereve të tjera, vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, vendimi i Komisionit është i ankimeshëm nga Komisioneri Publik, pasi dhënia e masës disiplinore të pezullimit nga detyra, si masa më e lehtë disiplinore e parashikuar nga ligji nr. 84/2016, lidhet vetëm me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale. Dhënia e kësaj mase disiplinore nga Komisioni nuk nënkupton që, për vlerësimin e dy kritereve të tjera, nuk ekzistojnë apriori shkaqe cenueshmërie. Në të kundërt, subjektet e rivlerësimit për të cilët do të jepej masa disiplinore e pezullimit nga detyra, do të vendoseshin në pozita më të favorshme, krahasuar me subjektet e rivlerësimit ndaj të cilëve Komisioni do të dispononte konfirmimin në detyrë, pasi për këta të fundit vendimi do të ishte vulnerabël kundrejt ankimit për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, në ndryshim nga subjektet e pezulluar për një vit dhe të detyruar për të ndjekur programin e trajnimit, për të cilët vendimi i dhënë do të ishte i paprekshëm, edhe pse mund të ekzistonte një vlerësim jo i drejtë e i bazuar i Komisionit.
23. Në vazhdim të këtij arsytimi, testi i *ratio-s* për nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës nuk e justifikon në asnjë rast ndalimin e ushtrimit të ankimit nga Komisioneri Publik për dy kriteret e tjera, vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, nëse ekzistojnë shkaqe për kundërshtimin e vlerësimit pozitiv të tyre nga Komisioni dhe dhënien e një mase tjetër disiplinore si shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit. E kundërta do të ishte rezultat i një interpretimi tepër të ngushtë të kësaj dispozite, që nuk përputhet me qëllimin e procesit të rivlerësimit të parashikuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës, që është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, rikthimi i besimit të publikut te ky sistem, si dhe me qëllimin kushtetues të ngritjes së institucionit të Komisionerëve Publikë për përfaqësimin e interesit publik, nëpërmjet paraqitjes së ankimit kundër vendimit të Komisionit¹⁵.
- Kur Komisioneri Publik, si një ndër organet rivlerësuese dhe përfaqësuese i interesit publik, në referencë të nenit 179/b të Kushtetutës, çmon se vendimmarrja e Komisionit rast pas rasti nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe provat, ka të drejtën kushtetuese ta ankimojë vendimin pranë Kolegjit, me përjashtim të vlerësimit të Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për të cilin ka dhënë masën disiplinore të pezullimit nga detyra dhe ndjekjen e programit të trajnimit për një periudhë 1-vjeçare. Në ndryshim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, ndalimi i ushtrimit të së drejtës së ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale për të cilin Komisioni ka disponuar me vendim dhënien e masës disiplinore

¹⁵ Neni C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës ka parashikuar se: “2. Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.”

sipas nenit 58, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, është i vlefshëm si për Komisionerin Publik, ashtu edhe për subjektin e rivlerësimit, duke vendosur në balancë të drejtat e tyre si palë në procesin e rivlerësimit, në përputhje me parimin e procesit të rregullt ligjor.

Bazuar në këtë arsyetim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet, pasi në Kushtetutë është parashikuar shprehimisht se ndaj vendimit të Komisionit me disponimin e pezullimit nga detyra për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, nuk lejohet ankimi, është një pretendim i pabazuar në ligj.

24. Në analizë të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik nuk duhet të pranohet, sepse është paraqitur në tejkallim të afateve ligjore për depozitim të tij, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se Komisioneri Publik e ka paraqitur ankimin më datë 25.10.2019, ndërkohë që shpallja e vendimit nga Komisioni është publikuar më datë 09.10.2019. Sipas subjektit të rivlerësimit, njoftimi i vendimit, bazuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, do të quhet i bërë që në datën e publikimit të tij në faqen zyrtare në internet të Komisionit. Në kushtet kur vendimi nr. 187, datë 24.07.2019, është publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionit, më datë 09.10.2019, afati për ankimin e tij mbaronte më datë 24.10.2019. Për këtë arsye, pretendon subjekti i rivlerësimit, duke u paraqitur më datë 25.10.2019, ankimi i Komisionerit Publik duhet të mos pranohet nga Kolegji, si ankimi i paraqitur tej afatit ligjor.

Nga verifikimi i akteve të dosjes së rivlerësimit të përcjellë nga Komisioni në Kolegji, trupi gjykues konstaton se vendimin për pezullimin e subjektit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, Komisioni e ka shpallur më datë 24.07.2019.

Vendimi i është njoftuar nga Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 08.10.2019, Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe ky i fundit, sipas dëftesës së shërbimit postar, e ka marrë njoftimin më datë 10.10.2019, protokolluar në këtë institucion me nr. {***} prot., datë 10.10.2019.

Ankimi i Komisionerit Publik Darjel Sina është paraqitur në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 25.10.2019, dhe është protokolluar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 25.10.2019.

Në analizë të kësaj situatë faktike në raport me parashikimin e neneve 55, pika 7 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit 56, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative, sipas së cilës: *Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati*, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik Darjel Sina ka paraqitur ankimi pranë Komisionit, protokolluar me nr. {***} prot., datë 25.10.2019, kundër vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit, ditën e pesëmbëdhjetë nga dita e njoftimit të vendimit, pra brenda afatit ligjor.

25. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se Komisioneri Publik, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* e *ratione materiae* për paraqitjen e ankimit, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik dhe i kundërankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto shkaqe

26. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas paragrafit 11.1.a më sipër, për deklaram të pamjaftueshëm të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 76 m², në Durrës, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.
27. Komisioni, në vendim, në lidhje me këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit për pagimin e kështit të parë në vlerën 20.000 euro, ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën 826.717 lekë¹⁶.
28. Komisioneri Publik ka kundërshtuar vendimin e Komisionit, me pretendimin se ky i fundit ka arritur në konkluzion të gabuar lidhur me vlerësimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 76 m², në Durrës, duke argumentuar se:
 - (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti në vlerën 20.000 euro, pasi depozita në shumën 1.048.000 lekë, që ai deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për këtë pagesë, nga aktet në dosje, rezultoi se nuk është tërhequr e gjitha përpara datës 30.04.2009, kur është kryer pagesa e kështit të parë.
 - (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti, pasi analiza financiare e kryer nga data 01.01.2009 - 30.04.2009, rezultoi me një diferencë negative prej të paktën 838.738 lekësh.
 - (iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, burimin për pagesën e kështit të dytë në vlerën 10.000 euro për blerjen e kësaj pasurie, pasi burimi nuk kanë qenë kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, siç ka deklaruar subjekti, por një hua e marrë nga shtetasi E. N..
29. Lidhur me këtë shkak të ankimit, gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit parashtroi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me apartamentin e banimit në Durrës, janë të pabazuara në provat e dorëzuara prej tij në Komision, të cilat janë administruar dhe shqyrtuar nga Komisioni, duke prapësuar sa vijon.
 - a) Kësti i parë i paguar për apartamentin e banimit është rezultat i kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, si dhe depozitave bankare në emër të tyre, siç rezultoi e deklaruar në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010.
 - b) Lidhur me mundësinë financiare të pagesës së këtij kësti, deri në datën 30.04.2009, duke analizuar të ardhurat totale të përfituara deri në këtë datë e duke zbritur më pas shpenzimet e jetesës, kuptohet qartë mundësia financiare për të paguar këtë këst. Totali i shumave të tërhequra nga llogaria bankare e pagës së subjektit të rivlerësimit, për periudhën nga 01.01.2008 - 31.12.2008, është 1.736.000 lekë. Përgjatë këtij viti, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën lekësh, të cilat më pas i ka konvertuar në euro me kursin e favorshëm të atij momenti, me qëllim akumulimin e ngadalshëm të shumës 20.000 euro, për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit. Të ardhurat e vitit 2008 nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, por ato kanë ekzistuar dhe, si të tilla, duhet të ishin përfshirë në analizë, pasi pagat e subjektit nuk janë përdorur të gjitha për përballimin e shpenzimeve të jetesës së vitit 2008. Pasaktësia jo e qëllimshme që rezultoi në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, në të cilën subjekti ka deklaruar si burim për pagimin e kështit të parë “depozitat dhe kursimet nga paga e bashkëshortes”, është ndrequr në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, në të cilën subjekti ka deklaruar si burim për pagesën e këtij kësti “të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, si dhe depozitat”.
 - c) Për sa i përket kështit të dytë, në vlerën 10.000 euro, për blerjen e apartamentit, subjekti ka argumentuar se huaja nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi

¹⁶ Faqja 10 e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit.

burimi real kanë qenë të ardhurat e tij nga depozita në Bankën Credins dhe huaja është shlyer brenda vitit kalendarik, menjëherë pas maturimit të depozitës së mësipërme.

30. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga palët lidhur me këtë shkak të ankimit, nga analiza e dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton, në mënyrë të përmbledhur, se:

o Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi, regjistruar në pronësi të Elvin Gokaj dhe Rr. G., më datë 17.06.2014: Zyra e Regjistrimit Durrës, Zona Kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, lloji i pasurisë apartament, sipërfaqja totale 76 m². Burimi: Kursime nga paga ime dhe e bashkëshortes ndër vite. Vlera: 30.000 euro. Pjesa takuese 100%.*

o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”: *Pasuri në vlerë leku, e ruajtur në banesë, me vlerë 1.377.615 lekë. Burimi i krijimit: Mbyllje e depozitave bankare dhe pagat e mia dhe pjesërisht të bashkëshortit.*

o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2009, subjekti ka deklaruar në rubrikën “Ndryshimet e interesave private”: *Kontratë sipërmarrjeje - apartament banimi, sipërfaqe 84,5 m² - lidhur me “{***}” ShPK, datë 30.04.2009. Burimi: mbyllje depozite datë 24.4.2009 në Raiffeisen Bank, shuma 1.048.600,66 lekë dhe pasuri në vlerë leku të ruajtur në banesë, në vlerën 1.377.615 lekë, të bashkëshortes, deklaruar në vitin 2009. Vlera: 30.000 euro. Pjesa takuese: 100%, ndërsa në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Detyrim financiar sipas kontratës së sipërmarrjes me objekt blerjen e apartamentit me sipërfaqe 84,5 m². Vlera 10.000 euro.**

o Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *Shlyerje e këstit të fundit (detyrim i deklaruar në vitet e mëparshme) ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, me mandat arkëtimi, datë 30.05.2014, dhe Kontratën noteriale shitje apartamenti, datë 30.5.2014 (shlyerje e borxhit me akt noterial nr. {***}, ky borxh është marrë për efekt të bankës, pasi afati për tërheqjen e depozitës ishte më datë 10.12.2014) dhe shlyerja është bërë më datë 30.05.2014, sipas marrëveshjes për dhënien e certifikatës së pronësisë me shoqërinë “{***}”. Vlera: 10.000 euro. Mbyllje depozite nr. {***} (pjesa tjetër është lënë për shpenzime të tjera familjare).*

31. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni¹⁷, subjekti, më datë 21.09.2018, ka deklaruar: “[...] në muajin maj 2014, më njofton noterja A. S. se më ka dalë certifikata e pronësisë së banesës për të cilën kisha për t’i shlyer shumën prej 10.000 eurosh, firmës “{***}” ShPK. E. N. më ofroi zgjidhje duke bërë një akt marrëveshje mirëbesimi, duke më dhënë hua këtë shumë, për një periudhë 6-mujore (pasi lekët për të shlyer shumën prej 10.000 eurosh i kisha kursyer në llogari bankare pranë Bankës Credins, në numrin e llogarisë {***}, me afat 1-vjeçar). Këtë shumë e kam marrë nga E. N., pasi nuk doja të ngarkohesha me penalitete të bankës për ndërprerjen e kontratës para afatit (llogari me afat 1-vjeçar, e cila është mbyllur më 10.12.2014).

Më datë 10.12.2014, kam bërë mbylljen e depozitës dhe jam paraqitur para noterit së bashku me z. E. N., duke i shlyer këtë hua të cilën ia kisha marrë para 6 muajsh, me akt noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2014. (Të gjitha veprimet noteriale dhe bankare i kam deklaruar në deklaratën pranë ILDKPKI-së për vitin 2014).”

Bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision dokumentacionin provues të këtyre deklarimeve:

¹⁷ Komisioni, më datë 20.09.2018, i ka drejtuar subjektit, pyetjen: “Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi E. N., lutemi sqarimet tuaja si më poshtë:

- a. Cila është lidhja juaj me shtetasin E. N.?
- b. Dokumentoni marrjen e huas.”

- Aktmarrëveshje, datë 30.05.2014, e lidhur mes shtetasve E. N. dhe Elvin Gokaj, në të cilën palët deklarojnë se z. E. N. i jep borxh z. Elvin Gokaj shumën prej 10.000 eurosh, për të shlyer këstin e fundit të banesës së tij, me kusht që ky i fundit t'ia kthejë në momentin më të parë të mbylljes së depozitës bankare që z. Elvin Gokaj ka pranë Bankës Credins. Kjo marrëveshje bëhet me qëllim që të evitohet ndërprerja e depozitës prej z. Gokaj, para afatit të caktuar. Afati i maturimit të kësaj depozite është data 10.12.2014. Palët kanë rënë dakord gjithashtu, që veprimet e shlyerjes së borxhit të kryhen para noterit publik, në afatin më të parë.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2014, e deklaruesve E. N. dhe Elvin Gokaj, të cilët deklarojnë se “[...] midis tyre ishte lidhur një marrëveshje huadhënieje në shumën 10.000 euro, shumë të cilën z. Elvin Gokaj e kishte marrë borxh nga z. E. N., më datë 30.05.2014. Kjo shumë ishte marrë borxh për shlyerjen e këstit të fundit në favor të shoqërisë ndërtimore “{***}” ShPK, për likuidimin përfundimtar të apartamentit të ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës. Në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate, z. Elvin Gokaj likuidon z. E. N. në prezencë të noteres publike, në shumën 10.000 euro, shumë të cilën z. Elvin Gokaj e ka tërhequr nga llogaria e tij pranë Bankës Credins, dega Durrës, më datë 10.12.2014.”

32. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për gjetjen: “Në përfundim të hetimit për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m² në Durrës, konstatohet se: [...] Subjekti duket se nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 826.717 lekë për pagimin e këstit të parë prej 20.000 eurosh, më datë 30.04.2009. Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti huan e marrë nga z. E. N..”

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ¹⁸, subjekti ka deklaruar: “Për sa u përket aftësive financiare për pagimin e këstit të parë të blerjes së apartamentit, u jam rikthyer deklarimeve periodike të pasurisë dhe, me qëllim pasqyrimin sa më të saktë dhe pa gabime të të gjitha lëvizjeve bankare nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes në atë periudhë, i jam drejtuar ekspertës kontabël të autorizuar, znj. M. U., [...] për të përgatitur aktin e ekspertimit, të cilin jua vë në dispozicion. Në aktin e ekspertimit, ekspertja ka konstatuar burimin e ligjshëm të të ardhurave për shlyerjen e këstit të parë, siç edhe është gjetur nga ana e Komisionit; gjithashtu ka kryer veprime kontabël për të rakorduar shifrat në fjalë, të cilat me të drejtë, janë konsideruar të pasakta nga ana e Komisionit. Deklaroj se këto parregullsi janë rezultat i njohurive të mia të pathëlluara në fushën ekonomike dhe ekspertiza i konsideron gabime njerëzore, pa pasoja diferencash në rakordimet kontabël. Në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting* kam deklaruar se burimi i shlyerjes së këstit të parë për blerje apartamenti në shumën 20.000 euro, më datë 30.04.2009, origjina e burimit është nga pagat e mia dhe të bashkëshortes.

[...] (Për këstin e dytë) Burim krijimi nuk është huaja e marrë nga z. E. N., por pagat dhe depozita bankare, e cila maturohej disa muaj më vonë sesa afati im për të shlyer këstin e fundit ndaj firmës “{***}”. Pra, arsyeja e marrjes së huas justifikohet nga pamundësia për të prekur depozitën para afatit të maturimit, sipas kushteve të bankës, e cila është realisht në vetvete burimi financiar i shlyerjes së këstit të dytë, e gjeneruar nga të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortes. Marrja e huas dhe shlyerja e saj me anë të mbylljes së depozitës brenda të njëjtit vit kalendarik, është deklaruar në deklarinimin periodik, ndërsa në deklaratën *vetting* janë kërkuar detyrimet ndaj të tretëve, çka në rastin tim, nuk kam pasur të tilla. Kam gjykuar të arsyeshme se duhet të shprehem për burimin e mirëfilltë të të ardhurave për shlyerjen e këstit të banesës.”

¹⁸ Rezultatet e hetimit administrativ, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, janë protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 07.06.2019.

Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur “Raport ekonomik”, datë 29.05.2019, i ekspertës kontabël të miratuar, znj. M. U., për periudhën 01.01.2008 - 30.04.2009, me qëllim argumentimin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur aftësi financiare (likuiditete) për pagimin e këstit të parë për blerjen e një apartamenti 1+1, me sipërfaqe 84,5 m², kësti i parë prej 20.000 eurosh, me mandat arkëtimi datë 30.04.3009, sipas kontratës së lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, më datë 30.04.3009.

Në përfundim të aktit të ekspertimit, ekspertja ka arritur në konkluzionin se: “Mbështetur në dokumente të certifikuara dhe të njohura me ligj, si konfermat bankare, të dhënat nga INSTAT dhe kursi nga Banka e Shqipërisë, rezulton se për periudhën 01.01.2008 - 30.04.2009, z. Elvin Gokaj ka pasur mjaftueshëm aftësi financiare (likuiditete) për pagimin e këstit të parë për blerjen e një apartamenti 1+1, me sipërfaqe 84,5 m², kësti i parë prej 20.000 euro, me mandat arkëtimi datë 30.04.3009, sipas kontratës së lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, më datë 30.04.3009.”

33. Nga verifikimi i llogarisë së depozitës së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, rezulton se në datën 01.04.2009, është maturuar depozita nr. {***} në shumën 1.048.600 lekë, nga të cilat janë tërhequr *cash* 500.000 lekë në datën 24.04.2009, ndërsa shuma 547.400 lekë është transferuar në të njëjtën datë nga llogaria e depozitës, në llogarinë e pagës së subjektit, me nr. {***}, në po të njëjtën bankë. Nga shuma 547.400 lekë që është transferuar në llogarinë e pagës, nga momenti i transferimit deri në datën 30.04.2009, datë kur është bërë pagesa e këstit të parë të apartamentit, janë tërhequr vetëm 120.000 lekë. Pra, gjithsej, nga kjo depozitë janë tërhequr 620.000 lekë dhe jo e gjithë shuma prej 1.048.000 lekësh, siç ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike të interesave për vitin 2009. Kjo situatë faktike është pranuar edhe nga vetë subjekti në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si dhe nga ekspertja kontabël e zgjedhur prej tij, e cila në aktin e ekspertimit ka pasqyruar të njëjtën lëvizje parash në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit.
34. Nga përshkrimi i fakteve si më sipër, trupi gjykues konstaton se për pasurinë apartament në Durrës, në dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Komision për këtë pasuri, ka mospërputhje të sipërfaqes së apartamentit, e cila u çmua prej tij si jo me rëndësi lidhur me vlerësimin e këtij shkaku. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se deklarimi i subjektit në deklaratën periodike të interesave për vitin 2009, se shuma 1.048.000 lekë e tërhequr nga depozita në Raiffeisen Bank ka shërbyer si një nga burimet për pagesën e këstit të parë për apartamentin, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, është deklarim i pasaktë, pasi shuma e tërhequr përpara datës 30.04.2009, nuk rezulton të jetë 1.048.000 lekë, por 620.000 lekë.
- Në kushtet kur vërehet se kjo pasaktësi në deklarimin e subjektit të rivlerësimit gjendet në deklarimin periodik të interesave, trupi gjykues, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij¹⁹, vlerëson se një deklarim i pasaktë në deklaratimet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit të sipërcituar.
35. Në verifikim të burimit tjetër të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2009 – pasuri në vlerë leku, e ruajtur në banesë, në vlerën 1.377.615 lekë – trupi gjykues konstaton se në deklaratën periodike vjetore të interesave të vitit 2008, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar para *cash* në banesë, në shumën 1.377.615 lekë, me burim nga mbyllja e depozitave bankare dhe nga pagat e dy bashkëshortëve. Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit në Bankën Raiffeisen, rezulton se në datën 27.11.2008

¹⁹ Vendimet e Kolegjit nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020.

është maturuar depozita me vlerë 523012 lekë dhe në datën 19.12.2008 është maturuar depozita me vlerën 204331 lekë. Këto shuma janë tërhequr *cash* nga llogaritë bankare në dhjetor të vitit 2008 dhe, për pasojë, janë deklaruar si gjendje *cash* në banesë nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2008.

36. Trupi gjykues vëren se në raportin e ekspertit kontabël të zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit dhe të paraqitur prej tij në Komision gjatë hetimit administrativ, të cilit ai i është referuar edhe gjatë gjykimit në Kolegj, eksperti kontabël ka analizuar likuiditetet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, për periudhën 01.01.2008 - 30.04.2009, në ndryshim nga Komisioni dhe nga Komisioneri Publik, të cilët periudhën e analizës financiare e shtrijnë nga data 01.01.2009 deri në datën 30.04.2009, datë kur është kryer pagesa e këstit të parë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 76 m² në Durrës, sipas deklarimeve dhe mandateve të pagesave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në vijim të logjikës së ndjekur nga eksperti kontabël, subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, pretendoi se gjithë kursimet e tij dhe të bashkëshortes për vitin 2008, të cilat janë diferenca mes të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve të kryera për këtë vit, duhet të ishin përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik, pasi ato janë përdorur realisht prej tij, për pagesën e këstit të parë sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 30.04.2009, lidhur me “{****}” ShPK, për apartamentin me sipërfaqe 76 m², në Durrës.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, në analizën financiare të kryer nga data 01.01.2009 - 30.04.2009, ka përfshirë në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij gjendjen e parave në banesë [*cash*], në vlerën 1377615 lekë, vlerë e cila është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën periodike të interesave të vitit 2008. Të njëjtën vlerë, subjekti, në deklaratën e interesave për vitin 2009, e ka deklaruar si burim krijimi për pagesën e këstit të parë sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 30.04.2009, lidhur me “{****}” ShPK, për apartamentin me sipërfaqe 76 m², në Durrës. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se bazuar në këto deklarime të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në deklaratimet e interesave vjetorë pranë ILDKPKI-së, të cilat sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016²⁰ shërbejnë si provë, vlera reale e kursimeve *cash* të subjektit dhe bashkëshortes së tij për vitin 2008 konsiderohet vlera prej 1377.615 lekësh. Eksperti kontabël i zgjedhur nga subjekti, duke kryer analizën për periudhën 01.01.2008 - 30.04.2009, ka përfshirë në përlllogaritje mundësinë e subjektit dhe të bashkëshortes së tij për të krijuar kursime në vitin 2008 dhe jo kursimet reale të deklaruara prej tyre.

Edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj, për të verifikuar mundësinë e subjektit për të paguar këstin e parë për apartamentin me sipërfaqe 76 m², për periudhën 01.01.2009 - 30.04.2009, konfirmohet rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik, sipas së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për të likuiduar këstin e parë të apartamentit, në vlerën 838738 lekë, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por kjo situatë, në vlerësimin e trupit gjykues, është e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

37. Në lidhje me pagimin e këstit të dytë në shumën 10000 euro, më datë 30.05.2014, për të njëjtën pasuri, Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, burimin për kryerjen e kësaj pagese, pasi burimi nuk kanë qenë kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, siç ka deklaruar subjekti, por një hua e marrë nga shtetasi E. N.. Lidhur me këtë pretendim, në mbështetje të situatës faktike dhe dokumentacionit të dorëzuar e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj,

²⁰ Pika 5 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikon: “5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit.”

ashtu siç është pasqyruar në paragrafët 29-32 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burim financiar për shlyerjen e këstit, kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2014 ka deklaruar shlyerjen e këstit të fundit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK dhe shlyerjen e borxhit ndaj shtetasit E. N..

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se huaja nuk është deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e kësaj pasurie, duke i kaluar atij barrën e provës për të dhënë shpjegime lidhur me këtë fakt, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se si burim për shlyerjen e këstit të dytë të apartamentit nuk është huaja e marrë nga z. E. N., por pagat dhe depozita bankare, e cila maturohej disa muaj më vonë sesa afati për të shlyer këstin e fundit ndaj firmës “{***}” ShPK. Pra, arsyeja e marrjes së huas justifikohet nga pamundësia për të prekur depozitën para afatit të maturimit, sipas kushteve të bankës, e cila sipas subjektit është realisht në vetvete burim financiar i shlyerjes së këstit të dytë. Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin e huas në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, si burim për pagesën e këstit të dytë, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e tij.

Të njëjtin qëndrim në lidhje me mosdeklarimin e borxhit të marrë nga shtetasi E. N., si burim financiar për pagimin e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në Durrës, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe gjatë gjykimit në Kolegj.

38. Duke qenë se në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se huan ia ka marrë z. E. N. për arsye se depozita e tij maturohej në një kohë të mëvonshme sesa afati për kryerjen e pagesës së këstit të dytë për apartamentin, trupi gjykues vlerëson se huaja prej 10.000 eurosh është marrë nga subjekti me qëllim kryerjen e pagesës së këstit të dytë më datë 30.05.2014, duke shërbyer në këtë mënyrë si burim i krijimit të kësaj pasurie, në mungesë të disponimit prej subjektit të të ardhurave të veta. Të ardhurat e subjektit nga maturimi i depozitës në datën 10.12.2014, kanë shërbyer si burim për shlyerjen e huas në të njëjtën datë, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2014, të deklaruave E. N. dhe Elvin Gokaj. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi në deklaram nuk mund të kualifikohet si një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
39. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson se situata faktike dhe ligjore e subjektit të rivlerësimit, e konstatuar për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m² në Durrës, nuk u gjet e mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
40. ***Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar depozitat e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së tij me persona të tjerë të lidhur, depozita këto të krijuara në periudhën 2010-2016 dhe se në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara në këtë periudhë,*** trupi gjykues, nga verifikimi i vendimit të Komisionit në lidhje me këtë çështje, konstaton se në mënyrë të përmbledhur, ai ka konkluduar se: “Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit, rezulton se ai ka qenë i saktë në deklaratën “vetting”, pasi llogaritë dyemërore janë mbyllur gjatë vitit 2016, sikundër është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë llogari. Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se mbajtësit e llogarive, prindërit e tij si dhe nëna e bashkëshortes së tij, kanë vërtetuar me dokumentacion provues

aftësinë financiare të tyre për të hapur këto depozita dhe, rrjedhimisht, nuk lindin dyshime që këto llogari të kenë si burim të ardhura të krijuara në mënyrë të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit.”

41. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar këtë konkluzion të arritur nga Komisioni në vendim, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit:

a) nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin depozitat e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së tij, respektivisht me znj. S. G. dhe znj. L. P.;

b) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010 – 2016, me një diferencë negative në total në vlerën 1.999.397 lekë.

Pretendimin për konkluzion të gabuar të Komisionit, lidhur me vlerësimin e llogarive bankare të përbashkëta të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nënën e saj dhe me nënën e subjektit, Komisioneri Publik e ka bazuar në këto argumente:

(i) Bashkëshortja e subjektit ka përfituar nga interesat e depozitave dyemërore.

(ii) Rezultojnë kalime fondesh nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit në llogarinë dyemërore në emër të Rr. G. dhe S. G. dhe anasjelltas.

(iii) Rezultojnë derdhje *cash* në llogaritë dyemërore të kryera nga vetë bashkëshortja e subjektit.

(iv) Nga shuma 1.010.010 lekë, që është transferuar nga llogaria L. P. dhe Rr. G. në llogarinë dyemërore S. G. dhe Rr. G. përfshihet jo vetëm shuma prej 1.000.000 lekësh, që është depozituar nga bashkëshortja e subjektit dhe që pretendohet se është një hua kundrejt nënës së subjektit, por përfshihet edhe teprica e llogarisë në emër të L. P. dhe Rr. G..

(v) Janë përfituar interesa nga depozitat dyemërore, duke i kaluar në llogarinë personale të bashkëshortes.

(vi) Ndryshe nga sa është deklaruar nga subjekti, bashkëshortja e tij në këto llogari bankare dyemërore është në cilësinë e depozituesit/titullare e llogarive bankare dhe jo “person i besuar/autorizuar”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, duke pasur detyrimin për deklarimin e tyre, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë” (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003”).

(vii) Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2010-2016 (periudhë kur janë krijuar këto depozita dyemërore) nuk është përfshirë në analizën financiare pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit në këto depozita bankare.

(viii) Nga përfshirja në analizën financiare të pjesës takuese të bashkëshortes në depozitat dyemërore, si dhe nga llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit sipas metodologjisë së sipërcituar, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016, duke rezultuar me diferencë negative 1.999.397 lekë.

42. Komisioneri Publik u qëndroi këtyre pretendimeve edhe gjatë gjykimit në Kolegj. Në zbatim të kërkesës së trupit gjykues, miratuar me vendim të ndërmjetëm²¹, lidhur me shkaqet e ankimit dhe në funksion të qartësimit të tyre, lidhur me depozitat dyemërore të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nënën e saj dhe nënën e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik përgatiti analizën mbi mundësinë financiare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, deri në datën e krijimit të këtyre depozitave, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burim nga të ardhura të ligjshme [50% pjesë takuese] depozitat dyemërore në datat e krijimit të tyre, me një diferencë negative prej 2.345.270 lekësh.

Komisioneri Publik, në gjykimin në Kolegj, në konkluzionet përfundimtare ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në deklaratat periodike të interesave nuk kanë

²¹ Në seancën gjyqësore të datës 06.11.2020.

deklaruar depozitat dyemërore dhe nuk mbulojnë me burime nga të ardhura të ligjshme pjesën takuese prej 50% të depozitave në këto llogari dyemërore, për pasojë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke plotësuar kërkesat e nenit 61, pika 3 për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

43. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në kundërankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me depozitat dyemërore janë të pabazuara në provat e dorëzuara prej tij, të administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, duke prapësuar sa vijon.

(i) Pas takimit sqarues të datës 17.02.2016 të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, nëna e tij S. G., më datë 06.06.2016, ka kaluar çdo llogari në emër të saj, si titullare e vetme e llogarive bankare, pa lënë asnjë person të autorizuar apo të besuar për të kryer veprimet.

(ii) Për të provuar të ardhurat e ligjshme të prindërve të tij, si dhe faktin se këto të ardhura nuk kanë qenë të tijat, subjekti ka paraqitur në Komision dokumentacion provues për burimin e të ardhurave të babait të tij. Lidhur me depozitën dyemërore midis bashkëshortes dhe nënës së saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision deklarata noteriale si dokumentacion provues për të ardhurat nga emigracioni i djemve të znj. P., si dhe për të ardhurat nga pensioni i familjarëve të bashkëshortes.

(iii) Referuar ligjit nr. 84/2016, subjekti ka provuar me prova se depozitat dyemërore nuk kanë qenë dhe nuk janë të ardhurat e tij apo të bashkëshortes së tij. Këto depozita nuk kanë qenë asnjëherë në pronësi, posedim apo përdorimin e tij ose të bashkëshortes së tij, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

(iv) Të ardhurat ndër vite të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij kanë qenë të mjaftueshme për jetesën, depozitat, si dhe likuiditetet përkatëse.

44. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, lidhur me llogaritë e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përkatësisht me znj. L. P. – nëna e saj – dhe znj. S. G. – nëna e subjektit të rivlerësimit – trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.

- Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, ka konstatuar:

“Nga hetimi administrativ ka rezultuar që për periudhën 2010-2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur llogari të përbashkëta në Credins Bank me znj. S. G. (nëna e subjektit të rivlerësimit) dhe znj. L. P. (nëna e saj).

Këto llogari nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat periodike të interesave privatë të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, te seksioni të dhëna konfidenciale të deklaratës së interesave të vitit 2015 të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja e tij deklaroi se lidhur me të gjitha depozitat që figurojnë edhe në emrin e saj, si person i autorizuar në Bankën Credins nga titullarja e kapitalit S. G. (vjehera), deklaroi se nuk ka asnjë pjesë të kapitalit apo interesit, por në rastin më të parë të ardhjes nga Italia të personit, do të bëjë shkëputjen e emrit.

Në lidhje me këtë konstatim, iu kërkua informacion subjektit të rivlerësimit në lidhje me përkatësinë e vlerave monetare në këto llogari, si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e tyre. Subjekti, më datë 11.12.2018, sqaroi se “çdo llogari bankare e çdo lloj banke që operon në Shqipëri, ku titullare e kontratës me bankën është nëna ime S. G., janë kursimet e prindërve të mi me të ardhurat ndër vite që kanë përfituar në Itali. Bashkëshortja ime nuk ka pasur asnjë rast të derdhjes apo tërheqjes së kapitalit pa praninë e nënës sime.” Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e të ardhurave të babait të tij, i cili përbëhet nga ekstrakti i datës 31 janar 2007 të Banka Popolare di Intra, në të cilën llogaria në emër të B. G. ka balancën 30.168,34 euro (më datë 24.01.2007, ka një kreditim në vlerën 21.130 euro, me përshkrim derdhje e çekut nga jashtë), ekstrakti i Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore, përkthyer, noterizuar nga A. S., në të cilin paraqiten të

ardhurat për periudhën 01.04.2001 - 15.10.2017), CUD ndër vite të z. B. G.. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat e babait të tij.

Bazuar në mandatin e datës 06.06.2016 të Credins Bank, rezulton se znj. S. G. ka transferuar shumën 30.000 euro (shuma totale e llogarive të përbashkëta) në llogarinë e saj personale në Credins Bank.

Referuar të dhënave nga Credins Bank, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një llogari të përbashkët me nënën e saj, znj. L. P.. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat, ashtu si ka bërë në rastin e llogarive të prindërve të tij.

Ndërkohë, më datë 14.08.2013, nga kjo llogari është transferuar shuma në vlerë 1010010 lekë, në llogarinë nr. {***}, në emër të S. G. ose Rr. G.. Llogaria në emër të S. G. ose Rr. G., më datë 06.06.2016, mbyllet me një tërheqje *cash* të shumës 1001900 lekë, pa u identifikuar personi që kryen këtë tërheqje”.

Në përfundim, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës për:

“a) Subjekti duket se nuk provon me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të ligjshme të nënës së bashkëshortes së tij, znj. L. P..

b) Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka deklaruar në lidhje me llogaritë dyemërore, pasi, siç rezulton, ka transferta bankare ndërmjet llogarive të prindërve të tij dhe nënës së bashkëshortes së tij.

c) Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja e transferimit të shumës 1010010 lekë nga llogaria e nënës së bashkëshortes së tij te llogaria e prindërve të tij, si dhe kush e ka tërhequr këtë shumë në datën 06.06.2016.”

- Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti, në lidhje me barrën e provës të kaluar nga Komisioni për depozitat dyemërore të bashkëshortes së tij me nënën e saj dhe me nënën e tij, ka deklaruar: “Në lidhje me paraqitjen e dokumenteve provuese për të ardhurat e znj. L. P., kam paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.12.2018, si dhe dokumentacionin bankar për llogarinë përkatëse. Po paraqes gjithashtu edhe dokumente provuese të marra nga puna në emigrim e djemve të saj, D. P. në Itali dhe F. P. në ShBA, si dhe vërtetimet e pensioneve. Llogaritë dyemërore të Rr. G. me S. G. dhe Rr. G. me L. P., nuk i kam konsideruar objekt të deklarimit të pasurisë, pasi kapitali i depozituar është në të gjitha rastet ose i S. G., ku person i besuar është Rr. G., ose i L. P., ku person i besuar është Rr. G., siç rezulton edhe nga deklaratat noteriale përkatëse të titullareve të kapitaleve respektive. [...] theksoj se nuk ka asnjë rast për transferta bankare të tilla nga llogaritë dyemërore S. G. dhe Rr. G. te llogaria e depozitës dyemërore L. P. dhe Rr. G. dhe anasjelltas. Në datën 14.08.2013, është çelur depozita nr. {***} në emër të S. G. dhe Rr. G. (person i besuar), e cila mbyllet me një tërheqje *cash* të shumës 1001900 lekë, më datë 06.06.2016. Ju vë në dispozicion mandatin e Bankës Credins, lidhur me këtë tërheqje që është kryer nga vetë S. G., e cila ia ka dhënë borxh këtë shumë me deklaratë noteriale, personit V. G.. Burimi i kësaj depozite është kthimi i borxhit që V. G. u kishte marrë më herët prindërve të mi, që në momentin e kthimit me miratim paraprak, i sjell te bashkëshortja ime, R. G., duke qenë se ishte personi i autorizuar për të kryer veprimet me bankat. Shuma 1010010 lekë është derdhur nga Rr. G. në llogarinë rrjedhëse dyemërore, me qëllim që S.G., me ardhjen më të parë në Shqipëri, të ketë mundësi të veprojë si ta gjykojë të arsyeshme me këtë shumë, veprim i kryer nga vetë S. G. më datë 14.08.2019. [...]

Lidhur me lëvizjet me urdhërhirime të brendshme, të kryera në llogaritë rrjedhëse dyemërore nga Rr. G., sqaroj se këto veprime janë kryer meqë Rr. G. ka pasur akses si person i besuar për të kryer veprime bankare edhe nga S. G., edhe nga L. P., dhe lëvizjet janë bërë gjithmonë në mirëbesim dhe porosi paraprake nga vetë titullaret e kapitaleve respektive.”

- Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka paraqitur kontratat e depozitave bankare dyemërore të bashkëshortes së tij Rr. G. me znj. S. G., si vijojnë.

- Kontratë depozite me afat, lidhur më datë 05.01.2012, mes Bankës Credins ShA dhe depozitueses S.G. ose Rr. G., në vlerën 4000 euro dhe afat maturimi 7-mujor.
- Kontratë depozite me afat, lidhur më datë 17.01.2015, mes Bankës Credins ShA dhe depozitueses S. G. ose Rr. G., në vlerën 3000 euro dhe afat maturimi 3-mujor.
- Kontratë depozite me afat, lidhur më datë 13.08.2010, mes Bankës Credins ShA dhe depozitueses S. G. ose Rr. G., në vlerën 5400 euro dhe afat maturimi 12-mujor.
- Kontratë depozite me afat, lidhur më datë 14.08.2013, mes Bankës Credins ShA dhe depozituesit S. G. ose Rr. G., në vlerën 5000 euro dhe afat maturimi 6-mujor.
- Kontratë depozite me afat për klientë individë, lidhur më datë 20.07.2010, mes Bankës Raiffeisen ShA dhe S. G. ose Rr. G., në vlerën 10000 euro dhe afat maturimi 6-mujor.

Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe deklaratat noteriale të mëposhtme.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.12.2018, me deklaruese L. P. dhe Rr. G.. Në të znj. L. P. deklaroi se asnjë pjesë e kapitalit të depozituar prej saj në cilëndo prej bankave apo në çfarëdolloj kohe kur janë kryer veprimet, nuk ka qenë dhe nuk është e ardhur e vajzës së saj Rr. G., por janë burime kryesisht nga puna e djemve të saj emigrantë. Emri i Rr. G. gjendet në veprimet bankare vetëm në cilësinë e personit të besuar prej saj, sipas rekomandimeve të punonjësve të bankës, dhe në asnjë rast, siç rezultoi nga dokumentacioni shoqëruar i bankave, nga ana e vajzës sime nuk është bërë tërheqje e ndonjë shume.

Ndërsa znj. Rr. G. deklaroi se asnjë pjesë e kapitalit të depozituar nga L. P. nuk i përket asaj dhe nuk është aset apo e ardhur nga puna apo kursimet e saj ndër vite.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.04.2019, me deklarues B. G. dhe S. G., të cilët deklarojnë se çdo llogari bankare në çdo lloj banke që vepron në Shqipëri, ku titullare e kontratës me bankën është S. G., është rezultat i kursimeve tona nga të ardhurat në Itali dhe se asnjë pjesë, përqindje apo shumë e tyre nuk është e djalit tonë Elvin Gokaj apo e bashkëshortes së tij Rr. G.. Ata kanë rënë dakord, sipas sugjerimit të punonjësve të bankave përkatëse, që znj. Rr. G. të ishte personi i autorizuar për të kryer çdo lloj veprimi që do të ishte i nevojshëm në lidhje me depozitat. Që nga viti 2016 e në vijim, S. G. është titullare e vetme e depozitave.

- Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2019, e z. V. G., i cili deklaroi se në muajin qershor të vitit 2013 i ka kthyer vlerën 1.000.000 lekë xhaxhait të tij B. G. (babait të subjektit të rivlerësimit), vlerë të cilën ia kishte marrë borxh më parë. Këtë vlerë, me porosi të xhaxhait, ai i ka dorëzuar nuses së djalit të xhaxhait, znj. Rr. G..

45. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe atyre të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në kundërankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, në raport me konstatimet e Komisionit, trupi gjykues verifikoi imtësisht llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortes së tij, si dhe llogaritë bankare të depozitave dyemërore të bashkëshortes së subjektit me znj. S. G. dhe znj. L. P., duke konstatuar të njëjtën situatë faktike si Komisioni dhe Komisioneri Publik.
46. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, *de jure*, ka qenë në cilësinë e depozitueses/titullares së llogarive bankare dyemërore me znj. L. P. dhe znj. S. G., pasi, sipas të dhënave të katër kontratave të depozitave, të lidhura me Bankën Credins²², znj. S. G. ose znj. Rr. G. janë në cilësinë e palës depozituese në këto kontrata. Sipas parashikimeve të secilës prej këtyre kontratave, palët bien dakord të marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet në lidhje me depozitën me afat. Pika 3 e paragrafit II “Veprimet me depozitën”, të secilës prej kontratave, parashikon se: *Depozita mund të çelet edhe në emër të dy ose më shumë personave, me kushtin që çdonjëri prej*

²² Kontratat e depozitave të përdorura nga Banka Credins për çdo llogari bankare depozite, janë kontrata tip.

mbajtësve të depozitës të ketë të drejtë të veprojë pavarësisht nga të tjerët (midis emrave të mbajtësve të depozitës të përdoret fjala lidhëse “OSE”), apo me kushtin që në momentin e kryerjes së veprimeve me depozitën të jenë të pranishëm të gjithë mbajtësit e saj (midis emrave të depozitës përdoret fjala lidhëse “EDHE”).”

Në referencë të nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, i cili parashikon se: *Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*, pjesa takuese e znj. Rr. G. në këto depozita është 50% e tyre.

Bazuar në këto parashikime kontraktore dhe ligjore, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë në cilësinë e depozitueses në këto llogari bankare, duke gëzuar të njëjtat të drejta e detyrime për to, si edhe depozituesja tjetër, znj. S. G..

47. Pavarësisht këtij përfundimi, duke vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ në lidhje me depozitat dyemërore të bashkëshortes së subjektit me nënën e saj dhe nënën e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të analizojë në vijim disa elemente të cilat u konsideruan prej tij të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.

Së pari, nga Komisioni është konstatuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit, si dhe nëna e bashkëshortes së tij kanë vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare të tyre për të krijuar këto depozita [në pjesën 100% të tyre]. Ky konstatim i Komisionit nuk është kundërshtuar nga Komisioneri Publik në ankim, madje gjatë gjykimit në Kolegj, është pranuar prej tij si konstatim i drejtë i Komisionit.

Së dyti, nuk ka rezultuar e provuar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe as gjatë gjykimit në Kolegj, se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave, në vite.

Së treti, ka rezultuar e provuar se depozita e dyemërore e znj. L. P. me znj. Rr. G. ka kaluar automatikisht për mbyllje në afatin e maturimit 29.05.2013, dhe znj. L. P. e ka tërhequr gjithë shumën përkatëse personalisht. Ndërsa znj. S. G. ka kaluar në llogarinë e saj personale gjithë kapitalin e depozitave dyemërore me znj. Rr. G., më datë 06.06.2016, pa lënë asnjë person të autorizuar apo të besuar për të kryer veprimet bankare, çka krijon bindjen se kapitali në llogaritë dyemërore ka qenë në pronësi të saj.

Së katërti, nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklarimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, se subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij kanë përdorur të ardhura nga këto depozita si burim krijimi për ndonjë pasuri të krijuar prej tyre apo për të përballuar shpenzime të caktuara. Kryerja e veprimeve të caktuara në llogaritë dyemërore prej bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se është bërë në kuadër të marrëdhënieve të posaçme familjare dhe të ndihmës për administrimin e tyre për llogari të nënës së tij dhe nënës së saj.

Në një vlerësim të harmonizuar të rrethanave të mësipërme, të kuadrit ligjor e të qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultoi e provuar gjatë këtij procesi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, ata nuk gjenden në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

48. ***Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë***, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik ka kundërshtuar vendimin e Komisionit, duke kërkuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi, sipas tij, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 3 dhe 5 të këtij ligji.

Pretendimin e tij se besueshmëria e subjektit të rivlerësimit në respektimin e ligjit është cenuar dhe, për rrjedhojë, edhe besimi i publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioneri Publik, në ankim, e ka bazuar në këto rrethana:

- a) subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë;
- b) në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar dukshëm se subjekti i rivlerësimit në rastet e trajtuara në vendim ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, duke marrë në konsideratë se një numër i konsiderueshëm i rasteve me mangësi të theksuara në gjykim, janë konstatuar si rezultat i denoncimeve të ardhura nga publiku;
- c) për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, në mungesë të informacionit nga ana e Shërbimit Informativ Shtetëror (në vijim “ShISh”).

49. Në lidhje me pretendimin si më sipër të Komisionerit Publik të parashtruar në ankim, megjithëse subjekti i rivlerësimit në kundërankim, por edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk ka parashtruar pretendime në lidhje me këtë shkak ankimi të Komisionerit Publik, trupi gjykues vlerëson se argumenti i Komisionerit Publik se besimi i publikut te sistemi i drejtësisë është cenuar për shkak se për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, në mungesë të informacionit nga ana e ShISh, është i pabazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, konstatohet se ky i fundit, në lidhje me vlerësimin e kriterit të figurës, është shprehur: *Procesi i rivlerësimit, në referim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj, ka vijuar mbështetur në administrimin e dokument/raportit të strukturës përgjegjëse për kontrollin e figurës; procedurës për kontrollin e saj; vlerësimit, verifikimit dhe standardeve të kontrollit bazuar në provat, informacionet konfidenciale, si dhe informacionet e tjera të disponuara nga grupi i punës i përbërë nga: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Shërbimi Informativ Shtetëror (ShISh) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (ShKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme²³.* Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për këtë kriter vlerësimi, konstatohet se në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, nga Komisioni është administruar informacioni i ShISh-it, i cili gjendet në dosjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

50. Për sa u përket dy argumenteve të tjera të Komisionerit Publik, trupi gjykues vlerëson se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon si një nga rastet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në interpretim të këtij parashikimi ligjor, që cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë të ngrihet në nivelin e shkeljes disiplinore për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duhet që ai të jetë i arsyeshëm, i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë. Në këtë kuptim, duhet që të provohet se ekzistojnë rrethana që në vetvete lidhen vetëm me një shkelje disiplinore dhe që nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin konkret, Komisioneri Publik, cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si masë disiplinore sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e lidh me mosarritjen nga subjekti i rivlerësimit të një niveli të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, për të cilën ka kërkuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në argumentet e tij, Komisioneri Publik e mbështet kërkimin për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar të njëjtën

²³ Në faqen 22 të vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit.

rrethanë [fakt] - mungesën e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e pasurive - për dy shkelje disiplinore të ndryshme: për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.

Të njëjtën linjë arsyetimi, Komisioneri Publik ndjek edhe për rrethanën tjetër, se në vlerësimin e aftësisë profesionale, një numër i konsiderueshëm i mangësive të theksuara në gjykim janë konstatuar nga Komisioni, si rezultat i denoncimeve të ardhura nga publiku për subjektin e rivlerësimit, duke thelluar bindjen për cenimin e besimit të publikut. Edhe në këtë rast, Komisioneri Publik e mbështet kërkimin për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar një rrethanë [fakt] - mangësitë e konstatuara në çështjet e identifikuar nga denoncimet e publikut - për të cilën subjektit i është dhënë nga Komisioni masa disiplinore e pezullimit nga detyra.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se argumentet e përdorura nga Komisioneri Publik për pretendimin e cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit shkojnë në drejtim të cenimit të parimit *ne bis in idem*.

51. Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon se shpjegimet e dhëna nga Komisioneri Publik si bazë për të pretenduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, nuk janë të arsyetuara e të analizuara, për të treguar shkeljet konkrete dhe mënyrën se si ato kanë ndikuar në cenimin e besimit të publikut, për pasojë pretendimi i Komisionerit Publik vlerësohet i pambështetur në fakte e në ligj.
52. Në përfundim të gjithë sa më sipër, trupi gjykues ka konkluduar si më poshtë.

52.1 Për vlerësimin e kriterit të pasurisë:

52.1.1 Trupi gjykues vlerëson se konkluzionet për subjektin e rivlerësimit, të konstatuara për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m² në Durrës, lidhur me:

a) mungesën e burimeve financiare të ligjshme për pagesën e këstit të parë të këtij apartamenti, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;

b) deklarimin e pasaktë të burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016; nuk u gjenden të mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklarime të pamjaftueshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

52.1.2 Lidhur me depozitat dyemërore të krijuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit me nënën e saj dhe nënën e subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi e provuar gjatë këtij procesi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave dhe, për rrjedhojë, nuk gjenden në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

52.1.3 Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet që të mos kalojë testin e standardit kushtetues dhe ligjor të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së tij, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

53. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
54. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit nr. 4, datë 29.06.2020, të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
55. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, ai duhet të konfirmohet në detyrë, në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke ndryshuar vendimin nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj dhe konfirmimin e tij në detyrë.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 18.11.2020, në Tiranë.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, votuam kundër vendimit të shumicës që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit Elvin Gokaj. Në vlerësimin tonë, në analizë të fakteve dhe provave kundrejt pretendimeve të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, ky i fundit duhet të ishte shkarkuar nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e kryer në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në shqyrtim të ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit Elvin Gokaj nuk arriti në nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kusht detyrues i vendosur nga ligji nr. 84/2016, në dispozitën e nenit 59, pika 1, germa “a”. Asnjë nga prapësimet e subjektit të rivlerësimit nuk ishte bindës për të arritur në përfundimin që pasuria e krijuar bazohej tërësisht në burime të ligjshme. Në konkluzion, trupi gjykues duhet të kishte pranuar kërkimin e Komisionerit Publik dhe të kishte vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.
2. Për këtë arsye, vlerësojmë se konkluzioni i shumicës se pasaktësia në deklaratën e pasurisë nuk “u gjet e mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm”²⁴ apo që mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën e përlllogaritur nga Komisioneri Publik në 838.738 lekë për shlyerjen e një kësti prej 20 mijë eurosh për pagesën e apartamentit në vitin 2009 është e tillë që “nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë”²⁵, është i pabazuar në ligj dhe bie ndesh qartë me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Po ashtu, në bindjen tonë, mungesa e burimeve të ligjshme dhe mangësitë në deklarin e huas së marrë nga z. E. N., duhet të ishin analizuar përgjatë pasaktësisë së deklaratës periodike vjetore të vitit 2009 të subjektit dhe të cilësoheshin si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
3. Në këtë dritë, duhet të ishte analizuar nga shumica edhe pretendimi i Komisionerit Publik për deklaram të pamjaftueshëm për depozitat dyemërore mes bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me persona të tjerë të lidhur [familjarë të subjektit dhe të bashkëshortes], të krijuara në vitet 2006-2010. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimin se depozitat bankare dyemërore të bashkëshortes së tij nuk përbëhen nga mjete monetare të cilat i përkasin subjektit dhe bashkëshortes, ashtu siç rezulton nga kontratat e depozitave. Subjekti nuk provoi për pasojë as që depozitat ishin krijuar tërësisht nga të ardhura të prindërve të tij apo të prindërve të bashkëshortes. Përkundrazi, në analizën e kryer gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezultuan rrethana faktike thuajse absurde – të ardhurat e depozitave kaluan mes dy individëve në marrëdhënie krushqie me njëri-tjetrin [nga llogaria e nënës së bashkëshortes së subjektit tek ajo e nënës së subjektit], dy individë lidhja e vetme e të cilëve është subjekti dhe bashkëshortja²⁶ – gjë që logjikisht mund të shpjegohet vetëm në kushtet kur këto fonde i përkasin subjektit dhe bashkëshortes, e cila në cilësinë e pronares disponon mbi këto fonde sipas vullnetit të saj.
4. Këto rrethana provuan qartë edhe mungesën e sinqeritetit të subjektit të rivlerësimit për sa u përket të drejtave të tij dhe të bashkëshortes si pronarë të këtyre pasurive të luajtshme. Vendimi i marrë nga shumica lidhur me këto depozita, përveçse bie ndesh me prezumimin ligjor që ½ e depozitës i përkiste ekonomisë familjare të subjektit të rivlerësimit, prezumim i cili ishte edhe premisa mbi të cilën u zhvillua debati gjyqësor, bie ndesh edhe me logjikën e thjeshtë ekonomike apo logjikën e thjeshtë. Në kushtet kur prindërit e subjektit të rivlerësimit jetojnë në një vend të Bashkimit Evropian, shumica nuk analizoi dhe subjekti nuk shpjegoi cili ishte motivi i prindërve të tij për të investuar në depozita kursimi në lekë në Republikën e Shqipërisë apo pse asnjë nga bankat në Republikën Italiane nuk ofronte motivim financiar të mjaftueshëm për të kryer të njëjtat investime me fitim.

²⁴ Shih paragrafët 38 dhe 39 të arsyetimit të shumicës.

²⁵ Po aty, paragrafi 36.

²⁶ Ndër të tjera, referuar edhe në mendimin e pakicës në Komision, paragrafi 7.3. – “Nga llogaria në euro në Credins e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, R. G. me nënën e saj, znj. L. P., kaluar më 14.08.2013 në llogarinë e znj. R. G. me vjehrrën e saj, S. G.. Shuma e kaluar 1.010.010 lekë.

A. Mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe deklarimi i pamjaftueshëm i burimit

5. Duke analizuar një e nga një elementet e përmendura më sipër, sa i përket mungesës së burimeve financiare për pagesën e këstit të parë të apartamentit nga subjekti, në vlerën 838.738 lekë në vitin 2009, konstatojmë se qëndrimi i shumicës se përse kjo shumë është e pamjaftueshme për ta përlllogaritur në funksion të kontrollit të kriterit pasuror dhe analizuar në dritën e parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mbeti i paargumentuar. Është veçanërisht me rëndësi të sillet në vëmendje që kjo vlerë monetare e pambuluar me burime të ligjshme, përbën 33% të të ardhurave në total të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes për vitin 2008 – total nga i cili nuk janë zbritur shpenzimet e përditshme të jetesës – apo 31% të të ardhurave të gjithë vitit 2009, dhe përbën 150% të të ardhurave të fituara prej tij dhe bashkëshortes për katër muajt e parë të vitit 2009, kur edhe ka ndodhur pagesa. Qartazi, shuma prej 838.738 lekësh, për të cilën mungojnë burimet e ligjshme për të financuar njërin këst të apartamentit, përbën një shumë të konsiderueshme në raport me të ardhurat vjetore të subjektit dhe të bashkëshortes. Për këtë arsye, vlerësimi i shumicës rezultoi i pabazuar.
6. Sjellim në vëmendje se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur shkarkim apo ka lënë në fuqi vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për deklarim të pamjaftueshëm të kriterit të pasurisë sipas nenit 61, pika 3, lexuar së bashku me nenin 33, pika 5, germa “b” [mungesë burimesh të ligjshme] në një numër çështjesh në të cilat mungesa e burimeve të ligjshme brenda një viti ka qenë në nivele shumë më të ulëta sesa kjo vlerë, përkatësisht 421.178 dhe 383.889 lekë²⁷. Për rrjedhojë, votuam që mungesa e burimeve të ligjshme të konstatuara në rastin e subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj për pagesën e këstit të parë të pasurisë në vitin 2009, duhet të ishte cilësuar në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën e konsoliduar deri më sot duke u cilësuar deklarim i pamjaftueshëm, mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar pasuri dhe të ardhura, në dritën e neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si pjesë e vlerësimit në funksion të besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.
7. Jemi dakord me shumicën se mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i huas prej 10 mijë eurosh nga z. E. N., që sipas subjektit të rivlerësimit ka shërbyer për të paguar këstin e dytë të apartamentit më 30.05.2014, përbën deklarim të pasaktë. Ndryshe nga shumica, në dritën e përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore dhe të jurisprudencës së Kolegjit²⁸, kjo pasaktësi e subjektit duhet të ishte pjesë e një konkluzioni për deklarim të pamjaftueshëm dhe e vlerësimit të kriterit pasuror në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është në përputhje me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, në një situatë me

²⁷ Shih vendimin nr. 7/2019 (JR) që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku. http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi_E-S-5-06_2019_I_ANONIMIZUAR.pdf. Nga leximi i paragrafëve që i përkasin analizës financiare të viteve 2011 dhe 2013 [paragrafët 33.1 - 33.5] dhe 32.6 të arsytimit të shumicës, në total mungesa e burimeve të ligjshme shkon në vlerën 421.178 për të dy vitet. Shih edhe vendimin nr. 2/2020 (JR) që i përket ankimit të Komisionerit Publik në çështjen e rivlerësimit të subjektit Besnik Cani. <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendim-B.-Cani-dhe-mendim-paralel-i-anonimizuar.pdf>, paragrafët 21.2, 21.3 dhe 24.5. Kolegji ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 621.085 lekë për pagesën e këstit të parë të apartamentit më 1 shtator dhe në total, në vitet 2005 dhe 2006, përkundër të ardhurave të subjektit të rivlerësimit ka burimet e ligjshme me diferencë negative në vlerën 383.889 lekë.

²⁸ Shih vendimin nr. 7/2018 (JR) që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha, paragrafët 45-50. <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendimi-i-plot%C3%AB-Mendimi-paralel-Mendimi-i-pakic%C3%ABs.pdf>.

rrethana faktike të ngjashme. Në vendimin nr. 7/2018 (JR), duke arsyetuar shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit edhe për shkak të deklarimit të pasaktë të një huaje që ka shërbyer për të krijuar pasuri dhe ishte shlyer tashmë në momentin kur subjekti plotësoi deklaratën e pasurisë [vetting], në zbatim të nenit D, pikat 2, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikave 7, 15, 18 dhe 22 të Udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të ILDKPKI-së, si dhe udhëzimeve në deklaratën e pasurisë (ligji nr. 84/2016, shtojca nr. 2), trupi gjykues ka arsyetuar:

“[...] Pra, kjo pasuri do të duhej të deklarohet prej tij se kishte si burim krijimi, ndër të tjera, pjesën e mbetur të pashlyer të kredisë deri më 31 janar 2017, si dhe pagat dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha me të cilat ai kishte shlyer pjesën takuese të vlerës së huas, për periudhën nga viti 2011 deri më 31 janar 2017. [46] Bazuar në sa më sipër, në lidhje me këtë shkak ankimor, trupi gjykues vlerëson të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...]”.

8. Për arsyet e shtjelluara më sipër, e gjejmë të gabuar dhe votuam kundër konkluzionit të shumicës se “[...] situata faktike dhe ligjore e subjektit të rivlerësimit, e konstatuar për pasurinë apartament me sipërfaqe 76 m² në Durrës, nuk u gjet e mjaftueshme për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...]”²⁹. Pretendimi i Komisionerit Publik për mungesën e deklarimit në lidhje me këtë aspekt, duhet të ishte pranuar sepse është i bazuar në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit³⁰ e të ishte pjesë e vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë. Si një ndër faktorët që, së bashku me sa shtjellohet në vijim, në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën, vendimi në këtë qasje duhet të përbënte bazë për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se, meqenëse huaja ishte shlyer prej tij brenda vitit, e përjashtonte detyrimin e tij për deklaram të kësaj huaje, është jobindës.

B. Depozitat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me persona të tjerë të lidhur

9. Votuam kundër qëndrimit të shumicës edhe për aspektin tjetër të vlerësimit pasuror, atë që u përket depozitave dyemërore të hapura nga bashkëshortja e subjektit me persona të tjerë të lidhur, në vitet 2010-2016. Sipas shumicës, “[...] nuk rezultoi e provuar gjatë këtij procesi që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij të kenë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave dhe, për rrjedhojë, në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, ata nuk gjenden në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 [...]”³¹.

²⁹ Paragrafi 39 i vendimit më sipër.

³⁰ Shih paragrafin 45 të vendimit të cituar në poshtëshënimin 5, më sipër.

³¹ Paragrafi 47 i vendimit.

10. Qëndrimi i mësipërm bazohet në interpretim të gabuar të ligjit dhe rrethanave faktike dhe duket se bazohet kryekëput në një interpretim arbitrar, bazuar vetëm mbi “posaçmërinë” e lidhjes mes subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur, e në anashkalim të qartë të konceptit që qëndron në themelet e kontrollit të pasurisë së zyrtarëve, përfshirë edhe praktikatat e fshehjes së pasurisë prej këtyre të fundit në emër të familjarëve. Ky interpretim, po ashtu anashkalon analizën ligjore të natyrës së depozitave dhe rolit aktiv dhe konsistent me atë të pronares, që rezultojnë të ketë pasur bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në disponimin me fondet e vendosura në depozitë, sikurse edhe me logjikën e thjeshtë. Konkretisht, përveç thirrjes në ndihmë të “marrëdhënies së posaçme”, dhe pavarësisht nga nevoja për ta kryer analizën e mësipërme, shumica hesht për kontradiktën në argumentet e subjektit. Konkretisht, nëse pranohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja e subjektit ishte në cilësinë e personit të *besuar* dhe jo pronare e në një masë të caktuar [nëse jo e gjitha] e vlerës monetare të depozituar, hapja e depozitave dyemërore të ndryshme, me dy personat e tjerë të lidhur, sfidon logjikën, ashtu siç sfidon logjikën përfitimimi nga lëvizja monetare mes individëve në marrëdhënie krushqie, nëpërmjet llogarisë së një individi që është vetëm person i autorizuar – sipas subjektit të rivlerësimit³². Më tej, duke pranuar pretendimin deklarativ të subjektit të rivlerësimit për rolin prej një personi të autorizuar të bashkëshortes, pavarësisht nga fakti që kontratat e depozitës i ka lidhur me cilësinë e bashkëpronares, trupi gjykues anashkaloi prezumimin ligjor për të pranuar një situatë faktike të bazuar vetëm në deklaratatë të subjektit.
11. Së fundmi, qëndrimi i shumicës bie ndesh edhe me analizën e lëvizjeve bankare të llogarisë dyemërore që, pasi kanë kaluar në llogarinë personale të bashkëshortes së subjektit [në vlerat 6.000 euro dhe 1.000.100 lekë] janë bërë pjesë e kapitalit të bashkëshortes, e kanë shërbyer për krijimin e depozitave personale të saj, deklaruar në deklaratën e pasurisë [vetting]. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se depozita e krijuar [më 14.08.2013] nga transferata e shumës prej 1.000.000 lekësh nga llogaria e bashkëshortes së subjektit me nënën e saj, znj. L. P., në llogarinë dyemërore të bashkëshortes me vjehrrën e saj, znj. S. G., vinte nga kthimi i një huaje. Sipas subjektit, huaja nga z. V. G. u ishte kthyer prindërve të tij, e për këtë qëllim u përdor llogaria dyemërore e nënës së subjektit me bashkëshorten e tij.
12. Shumica dështoi të analizonte me objektivitet mungesën e besueshmërisë së këtij pretendimi, në dritën e lëvizjeve bankare të dokumentuara, dhe pranoi përfundimisht një pretendim deklarativ përkundër konfirmimeve bankare. Konkretisht, ndryshe nga sa pretendoi subjekti, nga dokumentacioni rezultojnë se llogaria bankare nuk është krijuar nga një derdhje *cash* nga bashkëshortja [që do të provonte pretendimin e kthimit të huas nga z. V. G.]. Llogaria bankare rezultojnë të jetë krijuar pas një urdhërshirimi të brendshëm nga nëna e bashkëshortes [znj. L. P.], me destinacion nga llogaria dyemërore e saj me të bijën, bashkëshorten e subjektit, të llogaria e kësaj të fundit me të vjehrrën, znj. S. G.. Llogaria me znj. P. [vjehrra e subjektit] dhe bashkëshortes së subjektit është kredituar më 24.06.2013, me *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, teksa dy ditë më parë – më 22.06.2013 – znj. P. kishte tërhequr një shumë të ngjashme në *cash* nga depozita dyemërore me të bijën/bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, 990.000 lekë. Depozita dyemërore e krijuar më 14.08.2013, si pasojë e transfertës nga llogaria e përbashkët e znj. P. me bashkëshorten e subjektit të depozituar

³² *Shih poshtëshënimin nr. 3 më sipër, transaksioni në vlerën 1.010.010 lekë, më 14.08.2013, në Credins Bank.*

dyemërore mes kësaj të fundit [bashkëshortes së subjektit] dhe vjehrrës së saj [S. G.], rezulton të jetë krijuar në praninë e të dyja llogarimbajtëseve, gjë që bie ndesh me pretendimin e subjektit se nëna e tij nuk ishte e pranishme në Shqipëri në datën kur është çelur kjo depozitë. Së fundmi, subjekti nuk shpjegoi përse në rrethanat konkrete, ai dhe bashkëshortja nuk kishin zgjedhur një mënyrë veprimi që pasqyronte realitetin e pretenduar prej tij – se bashkëshortja ishte thjesht person i autorizuar – duke u pajisur me një prokurë për të kryer veprimet e nevojshme në mungesë e për llogari të dy familjeve përkatëse. Të gjitha këto fakte duhet të kishin udhëhequr vendimmarrjen e shumicës për të konstatuar që subjekti ishte i pasinqertë.

13. Nga analiza financiare e kryer në kuadër të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit rezultonte me mungesë të konsiderueshme burimesh të ligjshme për krijimin e depozitave, qoftë edhe në kufijtë e prezumimit ligjor të bashkëpronësisë në pjesë të barabarta, në vlerën afërsisht prej 3,5 milionë lekësh dhe teorikisht, mbi 7 milionë lekë. Në mungesë të një hetimi të thelluar në Komision, trupi gjykues do të duhet të kishte vlerësuar faktet në funksion të parimeve të kontrollit të pasurisë dhe të orientonte Komisionin në drejtim të përjashtimit të situatës faktike në të cilën fondet i përkasin subjektit të rivlerësimit si dhe të mundësisë reale të personave të tjerë të lidhur për krijimin e këtyre depozitave.
14. Konkluzioni i shumicës bie ndesh edhe me analizën e kontratave të depozitave bankare në fjalë, sipas të cilave “çdonjëri nga mbajtësit e depozitës ka të drejtë të veprojë pavarësisht nga të tjerët [...]” dhe analizës së kryer në dritën e dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë bashkëpronësinë dhe llogaritë bankare bashkëmërore, respektivisht nenet 199 dhe 1043. Sipas këtyre dy dispozitave, rrjedh që:
 - a. së pari, përderisa nuk provohet e kundërta – gjë që gjen vend edhe në rrethanat konkrete – pjesa e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes në këto depozita, përbën formalisht 50% të fondeve.
 - b. së dyti, bashkëshortja e subjektit dhe personat e tjerë të lidhur, respektivisht në secilën depozitë, janë kreditorë e debitorë solidarë të tepricave të llogarive. Arsyetimi i shumicës se “nuk rezultoi e provuar gjatë këtij procesi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij të kenë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave” në paragrafin 47, është i pabazuar në dispozitat kushtetuese që rregullojnë procesin e rivlerësimit, e në ligjin nr. 84/2016, ashtu si edhe alogjik. Në procesin e rivlerësimit, barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit³³.
15. Arsyetimi i shumicës për këtë element është alogjik pasi, në dritën e prezumimeve ligjore të Kodit Civil, për sa u përket depozitave dyemërore dhe bashkëpronësisë, barrën e provës për të provuar të kundërtën e kontribuimit e kishte vetëm subjekti i rivlerësimit. Përkundër

³³ Neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] 5. Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal. Neni A i Aneksit parashikon: “[...] Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, [...] dispozitat që lidhen me barrën e provës, [...] kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës. [...]”, dhe neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën [...]”.

prezumimeve ligjore më sipër, si dhe barrës së provës që mbante, shumica pranoi pretendimet e subjektit të mbetura në nivel deklarativ. Duke abstraguuar nga mangësitë e konstatuara në hetimin e kryer në Komision për sa u përket mundësive për të kontribuar në sasi të përkatëse me burime të ligjshme të provuara nga personat e tjerë të lidhur, trupi gjykues i Kolegjit, në kushtet e mungesës së provave në të kundërtën dhe, për pasojë, e gjendjes përpara pretendimeve deklarative të subjektit, duhet të kishte arsyetuar mbi bazën e prezumimit ligjor të bashkëpronësisë në pjesë të barabarta dhe të kishte konstatuar mungesë burimesh për pjesë takuese në vlerën përkatëse dhe që subjekti ishte në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Një gjetje e tillë, bazuar në detyrimin e subjektit për të provuar të kundërtën, do të ishte në përputhje me standardin e vendosur nga Kolegji në jurisprudencën e tij të deritanishme, në të paktën 14 çështje të gjykuara deri në momentin e marrjes së këtij vendimi³⁴. Për arsye se qëndrimi i shumicës bie ndesh me jurisprudencën dhe standardin e vendosur deri më sot në gjykimet në Kolegj, votuam kundër.

16. Nuk jemi dakord me shumicën edhe sepse në rrethanat faktike në fjalë, trupi gjykues i Kolegjit do të duhet t'i jepte orientim Komisionit në përputhje me parashikimet e nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 për të zgjidhur drejt në të ardhmen situata të ngjashme. Ashtu siç ka arsyetuar trupi gjykues i Kolegjit në vendimin nr. 26/2019 (JR)³⁵, në kushtet kur hetimi i Komisionit ishte i mangët, Kolegji do të duhet të orientonte Komisionin që situata faktike edhe në këtë çështje, të ishte hetuar në drejtim të fshehjes së pasurisë nga ana e subjektit, në kuadër të depozitave dyemërore, për të qartësuar çështjen.
17. Për sa më sipër, ne vlerësojmë se qëndron parashtrimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar depozitat e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së tij, të krijuara në periudhën 2010-2016 me persona të tjerë të lidhur, dhe se në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, *subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në këtë periudhë*. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare, minimalisht në vlerën e përlllogaritur nga Komisioneri Publik³⁶ për krijimin e gjysmës së depozitave – sipas prezumimit ligjor që dikton mënyra e krijimit të tyre si dyemërore dhe me të drejta të barabarta pronësie për bashkëpronarët – në vlerën negative prej 3,5 milionë lekësh (shih më sipër), duke pasur parasysh edhe që gjatë shqyrtimit gjyqësor trupi gjykues nëpërmjet analizës në Kolegj, konstatoi se pretendimet e Komisionerit Publik qëndronin sa i përket mungesës së burimeve për llogari specifike në

³⁴ Shih ndër të tjera: paragrafët 44 dhe 58 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit, Altina Xhoxhaj [JR nr. 09/2018], paragrafin 31 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Fatmir Hoxha [JR nr. 7/2018], paragrafin 60 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Adriatik Cama [JR nr. 05/2019], paragrafin 19 (ii) të vendimit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, Antoneta Sevdari [JR 6/2019], paragrafin 10.1.8 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli [JR nr. 9/2019], paragrafin 40.1. të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Thanza [JR nr. 10/2019], paragrafin 20.2/xi, paragrafin 22/iii dhe 25.8./I të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit, Rovena Gashi [JR nr. 12/2019], paragrafin 66 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka [JR nr. 15/2019], paragrafin 25 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Selmani [JR nr. 25/2019], paragrafin 43 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci [JR nr. 26/2019], paragrafin 46 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Admir Belishta [JR nr. 1/2020], paragrafin 41.7. të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Adnan Kosova [JR nr. 5/2020], paragrafët 48 dhe 49 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj [JR nr. 4/2020], dhe së fundmi, paragrafët 19.1 dhe 32.3 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini [JR nr. 26/2020].

³⁵ Shih paragrafin 78 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci [JR nr. 26/2019].

³⁶ Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, kjo diferencë përlllogaritet në vlerën prej përreth 3,5 milionë lekësh.

periudha të caktuara kohore, trupi gjykues duhet të kishte analizuar të gjitha burimet e ligjshme të munguara në tërësi dhe të konstatonte deklaram të pamjaftueshëm nga ana e subjektit të rivlerësimit.

18. Në të njëjtën kohë, arsyetimet e subjektit për mungesë dijenie të depozitave të bashkëshortes me nënën e tij dhe me nënën e saj për të paktën pesë (5) vjet, bien ndesh me detyrimet e tij ligjore si subjekt deklarues, por shkojnë edhe në kufijtë e qesharakes. Që një subjekt deklarues, magjistrat-drejtues i prokurorisë së apelit, të ketë disa llogari bankare që ka detyrim t'i deklarojë, e për të cilat është në errësirë për 5 vjet, sfidon logjikën. Pretendimi i subjektit do të ishte deri diku i pranueshëm nëse të paktën njëra nga llogaritë do t'i përkiste subjektit dhe bashkëshortes. Situata faktike që sugjeron subjekti dhe që u pranua nga shumica, është aspak bindëse. Pavarësisht se pretendimet që subjekti zgjodhi për t'u shpjeguar, nuk e shkarkojnë atë nga përgjegjësitë që ka sipas ligjit nr. 9049/2003, për t'i pasqyruar të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në deklaratat periodike vjetore, ato gjithsesi u morën parasysht nga shumica në një qasje që është në mospërputhje me ligjin dhe me praktikën ligjore/jurisprudencën e deritanishme të KPA-së.
19. Sjellim në vëmendje se subjekti i rivlerësimit e ka pasur barrën e provës gjatë gjithë procesit për të justifikuar depozitat dyemërore. Në funksion të kësaj barre prove, ai pretendoi se depozitat përbëheshin nga të ardhura nga emigracioni, megjithëse në rrethanat konkrete të faktit, rezultoi se bashkëshortja ka vepruar me fondet si pronare. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë se ishte në debat burimi i ligjshëm i krijimit të depozitave konkrete, të krijuara në kohë specifike të identifikuar dhe të analizuar kundrejt mundësive financiare të tij dhe bashkëshortes për t'i krijuar me burime të ligjshme. Për rrjedhojë, rregullsia e procesit për të nuk mund të vihet në diskutim.
20. Në këto kushte, edhe pse shumica nuk mori parasysht sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në kriterin e vlerësimit të pasurisë rezultoi me një diferencë negative burimesh të ligjshme që varion nga 3,5 milionë lekë sipas prezumimit ligjor, në mbi 7 milionë lekë teorikisht, në kushtet e hetimit të mangët të kryer nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, kjo mungesë e burimeve të ligjshme duhej të analizohet në dritën e kërkesave të nenit 59, pika 1, germa "a", e ligjit nr. 84/2016, si konkluzion që nuk konfirmon nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë. Për pasojë, në kushtet kur ligji dikton prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 187, datë 24.07.2019, duhet të ishte ndryshuar duke shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra.

Gjyqtare

Natasha MULAJ

nënshkrimi

Gjyqtare

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi